



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

Rreshen më 02.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Dru zjarri
-03413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 500 000 (Dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2026, sipas ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ku përcaktohen llojet e taksave dhe detyrimeve vendore si dhe detyrimet e subjekteve për pagimin e tyre, sipas afateve perkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon një mjet transporti jo më pak se 3.5 ton ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik pjesmarres duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin kamion ne pronësi ose ne perdorim (me qera) sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie.
- akt kolaudimi,
- policen e sigurmit te mjetit
- taksen vjetore

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të disponojnë një automjet të përshtatshëm për transportin e druve nëper shkolla sipas njësive administrative, huapërdorje ose me qera, i cili do të shërbejë për transportin e mallit objekt prokurimi dhe se për vërtetimin e disponimit të tij duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë, dhe të marrjes me huapërdorje ose me qira të mjetit, si dhe dokumentacionin sipas legjislacionin në fuqi për lejimin e qarkullimit të mjeteve. Njësia vendosi të kërkoj kushtin e mësipërm sepse ai ka lidhje të ngushtë me objektin e kontratës dhe është në përpjesëtim me objektin e kontratës. Njësia vlerëson se pa mjet transporti të përshtatshëm një operator ekonomik nuk mund të realizoj furnizimin dhe shkarkimin e druve të parashikuar në këtë prokurim.

2.3.3 Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi kualifikimi për të paktën 1 punëtor te specializuar ne fushën e perpunimit te drurit, të lëshuar me certifikate nga një institucion privat ose publik.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te ketë minimalisht 4 (katër) punonjës të siguar 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *Shënim* (4 punonjës gjithsej, perfshire dhe punonjësin me dëshmi kualifikim te permendur ne piken 2.3.3)

- a)** Kjo të dëshmohe me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kërkesa për të paktën 1 punonjës të kualifikuar në fushën e perpunimit dhe

përgatitjes së drurit lidhet me kërkesat teknike të mallit objekt furnizimi, i cili duhet të jetë i përgatitur në përputhje me dimensionet dhe kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike.

Duke marrë në konsideratë volumin e furnizimit prej 386.6mst dru zjarri dhe shpërndarjen në 6 njësi administrative, është kërkuar disponimi I minimalisht 4 punonjësve. Furnizimi nuk konsiston vetëm në sigurimin e mallit, por përfshin edhe proceset e ngarkimit, transportit, shkarkimit në pikat përkatëse të dorëzimit. Për shkak të shtrirjes territoriale të institucioneve dhe nevojës për realizimin e furnizimit në mënyrë të vazhdueshme dhe brenda afateve të përcaktuara, disponimi I një numri minimal prej 4 (katër) punonjësish vlerësohet I nevojshëm dhe proporcional me objektin, volumin dhe mënyrën e realizimit të kontratës

2.3.5Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të gjithë sasise se mallit të përfshire në këtë procedure prokurimi.

Me qëllim garantimin e përmbushjes së kontratës objekt prokurimi, njësia e prokurimit e vlerëson të domosdoshëm faktin që, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet detyrimisht të deklarojnë se marrin përsipër kryerjen e shërbimit të transportit të mallit/ materialit në vendodhjen/et që do të përcaktohen në planin e shpërndarjes të autoritetit kontraktor, kjo me qëllim për të përjashtuar mundësinë që kontraktuesi të pretendojë se një shërbim i tillë nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit për këtë prokurim, ku A.K., do t'i duhet që të paguajë kosto shtesë për transportin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike

- Drutë të jenë të prera dhe të çara
- Gjatësia e prerjes për konsum të jetë jo më e madhe se 25 deri në 30 cm
- Trashësia e seksionit rrethore nga 15 – 20 cm
- Drutë të jenë lisi ose ahu të thata.
- Të mos ketë dru të kalbura gjatë furnizimit .
- Transporti do të bëhet nga shitesi deri në objektet që janë nën juridiksionin e bleresit (sipas grafikut të shpërndarjes) duke qënë e mundshme matja e volumit të mallit nga blerësi.
- Malli do të bëhet hyrje kur pritësit e mallit në objekt të jenë dakort për cilësinë dhe sasinë e mallit.
- Sasia e mallit që do të blihet (dru zjarri) është **386 mst**

- Afati i lëvrimit të lëndës drusore është sipas kërkesave të AK duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. Ky lëvrim do të kryhet me mjetet e operatorit ekonomik fitues në adresën e Autoritetit Kontraktor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Drutë duhet të dorëzohen në çdo objekt (*shkolla, kopshte dhe çerdhe*) sipas Njësive Administrative të Bashkisë Mirditë.
- Drutë duhet të jenë të stivosura në objekt nga OE dhe do të merren në dorëzim brenda orarit zyrtar të punës dhe jo në ditë pushimi apo festash zyrtare.
- Furnizimi do të bëhet nga kontraktuesi me automjetet e tij nga pika e furnizimit deri në destinacion sipas grafikut të lëvrimit të mallit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë të hartuara nga grupi i punës i ngritur për përlogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

U ra dakort nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”** me fond limit prej: **2 500 000** (Dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa Tvsh, **lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar, Mallra.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: